

Kerkese per informacion Nr. Prot 164/21

164/1

Koordinatori Informimi <Koordinatori.Informimi@drejtesia.gov.al>
 To: Res Publica <qendra.respublica@gmail.com>

Thu, Dec 16, 2021 at 11:45 AM

Përshëndetje,

Në cilësinë e kërkuetit keni depozituar në rrugë shkresore/elektronike përmes emailit Koordinator Informimi të drejtesia.gov.al pranë Ministrisë së Drejtësisë, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", kërkesën për dhënie informacioni, regjistruar me numër 69 rendor datë 14.12.2021.

Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni përgjigjen nga struktura përkatëse në Ministrinë e Drejtësisë:

Në përgjigje të kërkesës saaj. ju informojme se :

Pranë Ministrisë së Drejtësisë është administruar kopje e Vendimit nr. 2892 (2955), datë 21.10.2021, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tirane, dërguar nga kjo gjykatë, protokolliuar prapa nesh me shkresën nr.2799/9 Prot., datë 10.11.2021 me lëndë "*Dëftesë Komunikimi*".

Në përfundim të gjyqimit, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tirane ka vendosur

- ✓ • Pranimin e përscham të kërkesës-padisë;
- ✓ • Shfuqizimin e vendimit nr. 3, datë 06.05.2021, të Bordit Disiplinar të Dhomës Kombëtare të Noterisë;
- ✓ • Shfuqizimin e Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë nr 351, datë 26.05.2021 "*Për heqjen e licencës së ushtrimit të profesionit të noterit, noteres Rezarta Koçi*";
- ✓ • Dhënen e vendimit me ekzekutim të përkohshëm.
- ✓ • Rrezimin e padisë për pjesën tjetër të objektit
- ✓ • Shpenzimet gjyqësore t' ngarkohen pales së paditur, Ministrisë së Drejtësisë dhe Bordit Disiplinar të Dhomës Kombëtare të Noterisë

Ministria e Drejtësisë po merr masat mbij qëllimin të gjitha institucioneve publike dhe private, të cilat lidhen ngushtësisht me ushtrimin e profesionit të noterit, pr qëllimin e Vendimit nr. 2892 (2955), datë 21.10.2021 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tirane, e cila ka vendosur "Shfuqizimin e vendimit nr. 3, datë 06.05.2021, të Bordit Disiplinar të Dhomës Kombëtare të Noterisë, shfuqizimin e Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë nr 351, datë 26.05.2021 "*Për heqjen e licencës së ushtrimit të profesionit të noterit, noteres Rezarta Koçi*" dhe Dhënen e vendimit me ekzekutim të përkohshëm". E njëjta për ushtrimin e veprimtarisë noterale.

Arkiva e noteres Rezarta Koçi, rezultoi se disponohet nga vete ajo.

Duke ju falenderuar